



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:252208
Datë: 29.08.2023
Numri i dokumentit: 04626280
C.nr.1436/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJ.- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Blerim Beshtica, në çështjen kontestimore të paditësve M.J., Z.J., D.J., T.J., të gjithë nga GJ., N.M., nga P.dhe O.P., nga F.K., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. V.P. nga GJ., kundër të paditurit B(B).K., nga GJ., nga GJ., Rr. “M.” nr.22, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. H.J., nga GJ., me objekt kontesti, padi për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit 3,200.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 29.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Ndërprehet procedura në këtë çështje kontestimore për shkak të vdekjes së të paditurit B(B).K., nga GJ..

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj kur trashëgimtarët e të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë, apo me propozimin e palës kundërshtare.

III. Seanca gjyqësore e caktuar për datën 22.09.2023 në ora 14:00, revokohet.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 20.08.2006 kanë paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit, me objekt kontesti, padi për vërtetimin e pronësisë.

Lidhur me këtë çështje është vendosur meritorisht sipas Aktgjykimit C.nr. 651/2006 të datës 15.06.2016 (nga gjyqtar tjetër), mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës, për shkak të ankesës së parashtruar nga pala paditëse, me Aktvendimin e saj, AC. nr. 3183/16 të datës 11.10.2021 e ka prish Aktgjykimi i sipërcekur dhe lëndën ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendsoje.

Në procedurë të rigjykimit dhe rivendosjes, gjykata me datë 22.09.2023 e ka caktuar seancën gjyqësore, dhe i ka dërguar ftesat për palët, por për të paditurin nga dorëzuesi i postes është shënuar në fletëdergesën për dorëzimin personal konstatimi se pala është i vdekur.

Duke pas parasysh faktin se për të paditurin është shënuar konstatimi në fletëdërgesën për dorëzim personal se i njejtë ka vdekur, gjykata nga Komuna e GJ.t-Zyra e Gjendjes Civile ka kërkuar që të verifikojë në evidencat të cilat ky organ i posedon dhe ta informojë gjykatën lidhur faktin e vdekjes së të paditurit. Nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme të Komunës së GJ.t, më datë 04.08.2023, kësaj gjykate i janë kthyer shënime zyrtare përmes të cilës është njoftuar se i padituri B.K.gjindet në sistemin e gjendjes civile si i vdekur, me ç'rast këtij njoftimi edhe ia ka bashkëngjitur edhe Certifikatën e Vdekjes, me numër rendor 417, të lëshuar nga ZGJC GJ.me datë 16.08.2023, me të cilën konstatohet se i padituri ka vdekur me datë 14.09.2022.

Sipas nenit 277, paragrafi 1, pika a) të LPK-së lidhur me nenin 18 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së, është paraparë se në rastet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësin procedurale, procesi gjyqësor ndërpritet, ndërsa me nenin 280.1 të po këtij ligji është paraparë se procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277, paragrafi 1, pika a) dhe d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Në rastin konkret rezulton se i padituri B.K.ka vdekur, dhe si rrjedhojë në bazë të të cekurave më lartë, procedura duhet ndërprerë, andaj edhe gjykata vendosi si në dispozitivin I dhe II të këtij aktvendimi.

Gjykata duke marrë për bazë faktin se procedura është ndërprerë, e ka revokuar seancën për datë 22.09.2023, andaj edhe vendosi si në dispozitivin III të këtij aktvendimi.

Ngase arsytet e cekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJ.
C.nr.1436/2021, me datë 29.08.2023.**

Gjyqtari,

Blerim BESHTICA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kesaj gjykate.

Vendimi i perkthyer në gjuhë serbe ti dorëzohet palës paditëse